

# **RAPORTI PARAPRAK I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**


## **AKTIVITETI: NDERTIM HOTELI (ME FUNKSIONE AKOMODIMI, SHËRBIMI, BODRUM)**

**VENDI:** ZONA KADASTRALE 8541, PASURIA NR. 26/57,  
LAGJA: 18 SHTATORI” GJIROKASTËR

**LAGJA:** 18 SHTATORI  
**BASHKIA:** GJIROKASTËR  
**QARKU:** GJIROKASTËR  
**SUBJEKTI JURIDIK:** “ALFA GJ” SHPK  
**ADMINISTRATOR:** ALFRED KOCIU

### **Grupi i Punës**

**Prof. Asoc. Dr. Rexhep Shkurti**  
Ekspert VNM vendim Nr.6 Nr.21 regj

  
EKSPERT  
REXHEP  
SHKURTI  
GJIROKASTER ALBANIA.

**Filip Cami**  
Arkitekt – Urbanist  
Nr. Liç: A-0741

  
FILIP ÇAMI  
ARKITEKT-URBANIST  
NR.LIÇ.A-0741

## PASQYRA PËRMBLEDHËSE

- 1.1. Hyrje
- 1.2. Emërtimi, qëllimi dhe lloji i aktivitetit.
- 1.3. Procedura prapake e VNM
- 1.4. Metodika e studimit
- 1.5. **KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR.**

### 1.6. Kuadri Ligjor Ndërkombëtar

## 2. ETAPAT E PROÇESIT TË OPERIMIT

### 2.1 Faza para ndërtimit

#### 2.2. Faza e ndërtimit

#### 2.3. Faza e operimit

#### 2.4. Karakteristikat e projektit

##### 2.4.1. Madhesia e projektit

## 3. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I MJEDISIT NË ZONËN NË STUDIM.

### 3.1. QËLLIMI I PROJEKTIT

#### 3.2. Pozicioni gjeografik.

#### 3.3. Mjedisi Fizik.

##### 3.3.1. Kushtet klimaterike.

##### 3.3.2. Pedologjia dhe Gjeologjia e zonës.

##### 3.3.3. Klasifikimi gjeoteknik i shkëmbinjve dhe karakteristikat gjeologo – inxhinjerieke të tyre.

##### 3.3.4. Hidrologjia.

#### 3.4. Mjedisi biologjik

#### 3.5. Zona të mbrojtura, habitate dhe zona të ndjeshme. Specie në rrezik dhe grupime të veçanta.

### 3.6. MJEDISI SOCIAL.

#### 3.6.1. Popullsia dhe infrastruktura

## 4. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR.

### 4.1. Procedura ndërtimore.

## 4.2. EFEKTET E MUNDSHME TË PROJEKTIT NË MJEDIS

### 4.2.1. Efektet gjatë fazës së para-ndërtimit

**4.2.2. Efektet gjatë fazës së ndërtimit**

**4.2.3. Degradimi i tokës**

**4.2.4. Zhurma**

**4.2.5. Emetimet në ajër**

**4.2.6. Krijimi i mbeturinave**

**4.2.7. Shkarkimi i ujërave**

**4.2.8. Shëndeti i punëtorëve dhe siguria**

**4.3. Masat gjatë fazës së para ndërtimit**

**4.4. Masat gjatë fazës së ndërtimit**

**5. PROJEKTI QË DO TË APLIKOHET.**

**5.1. FILLIMI I PROJEKTIT**

**5.2. FAZA E NDËRTIMORE E OBJEKTIT.**

**6. NDIKIMET NË MJEDIS.**

**6.1. Ndikime në tokë**

**6.2. Ndikimi në larminë biologjike.**

**6.3. Krijimi i pluhurave.**

**6.4. Krijimi i zhurmave gjatë punimit.**

**6.5. Ndikime në sistemet hidrike.**

**6.6. Ndryshimi i relievit ekzistues.**

**6.7. Ndikime në komunitet.**

**6.8. Ndikime në trashëgiminë kulturore**

**6.9. Ndikimet nga emesionet**

**6.10. Ndikimet në cilësinë e ajrit**

**6.11. Ndikimi në shërbimet publike**

**6.12. VLERËSIMI PËRMBLEDHËS I NDIKIMEVE NË MJEDIS**

**7. VLERËSIMI ANALATIK I SHKARKIMEVE DHE MËNYRA E TRAJTIMIT TË TYRE**

**7.1. Shkarkimi i gazeve**

**8. PLANI I MONITORIMIT MJEDISOR (PMM)**

**9. MONITORIMI I MJEDISIT**


## 1.1 Hyrje

Subjekti juridik “ALFA GJ” shpk aplikues për VNM paraprake është regjistruar në QKR me numër NIPT J62903674R, me përfaqësues ligjor z. Alfred Koçiu.

Me kërkesë të shoqërisë “ALFA GJ” sh.p.k., shoqëri ndërtuese dhe projektuese është kërkuar hartimi i “Raportit Paraprak të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”.

Subjekti “ALFA GJ” sh.p.k., është kontraktuar nga pronari i truallit z. Bejkush Tola për ndërtimin e një Hoteli me 6 kate. Pronari në vendin e përzgjedhur për ndërtimin e hotelit posedon truall ndërtimi së bashku me objektin ekzistues. Për këtë qëllim parashikohet prishja e objektit ekzistues dhe ndërtimin e një objekti të ri me funksione hotelerie.

Ky studim vlerësimi paraprak i ndikimit në mjedis është bërë me kërkesë të subjektit ndërtues, me qëllim paraqitjen në autoritet përkatëse të Mjedisit për pajisje me leje zhvillimore konform ligjit nr. 10 440 datë 7/7/2011 *“Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” shtojca II “Projekte që i nënshtrohen procedurës paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, pika 10, “Prodhime Infrastrukturore”, shkronja b “Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregëtare dhe parkimet për makinat”*



Vendi i përzgjedhur për ndërtimin e objektit ndodhet në zonën kadastrale 8541, pasuri me nr. 26/57, me sipërfaqe të përgjithshme 167.5 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 147m<sup>2</sup>, zona kadastrale 8541, pasuria Nr. 26/57, lagja “18 Shtatori” Bashkia Gjirokastrë.

## Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis – “Ndërtim Hoteli”

Studimi i ndikimit në mjedis është përqëndruar në evidentimin dhe vlerësimin e shkallës së ndikimit mjedisor të ndërtimit dhe shfrytëzimit të hotelit, në përcaktimin e burimeve të mundshme me impakt negativ që mund të krijohen gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të objektit të sipërcituar. Një tregues me rëndësi në material është vlerësimi i ndikimit në komunitet i ndërhyrjes në mjedis nga ndërtimi i objektit si dhe masat e marra për minimizimin e këtyre ndikimeve.

Për një vlerësim sa më të mirë të territorit të përzgjedhur, në rajonin e kërkuar është bërë rilevimi në tërësi, ku janë evidentuar të dhëna gjeologjike, klimaterike, faunistike, floristike, humanitare, projekti i shfrytëzimit, etj.

Për realizimin e studimit krahas kryerjes së rikonjucionit për njohjen e terrenit u përdorën materiale arkivore studimore të ndryshme mbi gjeografinë, klimën, gjeologjinë, biologjinë e zonës, etj.

### **2.1. Emërtimi, qëllimi dhe lloji i aktivitetit.**

**Emërtimi i aktivitetit: “Ndërtim Hoteli”. Qëllimi i studimit dhe i përgatitjes së raportit paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis është që nga aplikuesi i këtij projekti të arrihet të merret miratimi në instancat përkatëse për destinacionin e përzgjedhur për sipërfaqen e kërkuar si dhe për ushtrimin e aktivitetit në ndërtimin e objektit Hotel në përputhje me legjislacionin e shtetit Shqiptar.**

Aktiviteti i propozuar nga subjekti “Ndërtim Hoteli” ka të bëjë me prishjen e një banese ekzistuese (godinë një katëshe) që gjendet në zonën kadastrale 8541 me nr. Pasurie 26/57, me sipërfaqe prone 176.5 m<sup>2</sup>, në lagjen “18 Shtatori” dhe njëkohësisht ndërtimin e Hotelit (me funksion akomodimi, shërbimi, bodrum) me sipërfaqe ndërtimore 147m<sup>2</sup>. Ky objekt do të shfrytëzohet për qëllime hotelerie. Aplikimi i kësaj VNM bëhet në kuadër të miratimit të lejes ndërtimore nga instanca përkatëse ku paraprakisht kërkohet pëlqimi nga agjencia mjedisore për përputhshmërinë e objektit me mjedisin në kuadër të mungesës së një master plani studimor urban mjedisor për zonën përkatëse.

Ky raport është një përmbledhje ekzekutive që përmban elementët kryesorë të V.N.M. Paraprake dhe është hartuar me qëllim miratimin e lejes zhvillimore për shfrytëzimin e sipërfaqes së kërkuar si dhe miratimin nga autoritetet përkatëse për ndërtimin e objektit të kërkuar nga kërkuesi.

Në **V.N.M.** e hartuar gjenden të trajtuara elementët e mëposhtëm:

- një përmbledhje e ligjit të aplikuar shqiptar mbi mjedisin si dhe standartet e rregulloren e ndjekur gjatë përgatitjes së V.N.M Paraprake.

## Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis – “Ndërtim Hoteli”

- Një përshkrim të përgjithshëm të mjedisit në zonën e studimit.
- Një përshkrim të veprimtarisë së kërkuar për prishjen e banesës ekzistuese dhe ndërtimin e hotelit sipas projektit teknik të hartuar nga arkitekti.
- Marrjes në konsiderate të çështjeve të mjedisit që në fazën e përgatitjes së propozimit në projekt.
- Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit.
- Një përshkrim të metodologjisë së punës për shfrytëzimin e sipërfaqes të kërkuar dhe prezantimet kohore dhe hapsinore të proceseve operacionale në raport me impaktin komunitar.
- Identifikimi dhe klasifikimi i problemeve dhe burimeve të ndjeshme të mjedisit.
- Përcaktimi dhe analiza e influencave të mundshme mbi mjedisin nga aplikimi i projektit të propozuar.
- Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis gjatë aplikimit të projektit.

**V.N.M. Paraprake** u përgatit duke u bazuar në njohjen e terrenit, në studimin e literaturës për probleme klimaterike, pedologjike, gjeologjike, biologjike, etj dhe mbi këtë bazë përgatitjen e një raporti paraprak vlerësimi me shkrim.

Në kuadër të këtij studimi janë evidentuar disa nga mundësit e ndikimit në mjedis, të cilat do të paraqiten në vazhdim sipas fazave të projektit.

### **2.2. Procedura praprake e VNM**

Hartimi i kësaj VNM për procedurë praprake është bazuar në ligjit nr. 10 440 datë 7/7/2011 *“Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” shtojca II “Projekte që i nënshtrohen procedurës praprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, pika 10, “Prodhime Infrastrukturore”, shkronja b “Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregëtare dhe parkimet për makinat”*

### **2.3. Metodika e studimit**

Studimi i vlerësimit të ndikimit në mjedis u orientua nga rëndësia e veprimtarisë, vendi ku ndodhet, pasuritë natyrore dhe humane të zonës si dhe vlerat e veçanta të tyre në identifikimin e ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave të zhvilluesit. Evidentimi dhe marrja e masave për reduktimin e impakteve të mundshme negative në VNM është ndërthurur me evidentimin dhe promovimin e impakteve pozitive të këtij aplikimi në komunitet, mjedis, etj.

***Studimi është konceptuar dhe realizuar në këto etapa:***

- 1- Platforma qëllimore dhe vepruese e VNM Paraprake

## Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis – “Ndërtim Hoteli”

- 2- Grumbullimi i materialeve kryesore ekzistuese, por dhe të atij të përpunuar posaçërisht për realizimin e këtij objekti.
- 3- Verifikimi në terren i të dhënave ekzistuese dhe mbledhja e të dhënave të mundshme gjeologjike, pedologjike, biologjike dhe humane.
- 4- Hartimi i projektit bazuar tek parashtesa si dhe subjektet vendim-marrëse dhe kontrolluese të veprimtarive mjedisore në nivel lokal.

### **2.4. KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR.**

Përgatitja e Raportit Paraprak të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis me të gjithë elementët organik, si pjesë e dokumentacionit që duhet për të marrë miratim për ndërtimin e objektit “Hotel” është bërë duke patur në referencë këto akte ligjore e rregullatore Mjedisore.

1. Ligji nr.10 440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, ***shtojca II “Projekte që i nënshtrohen procedurës paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, pika 10, “Prodhime Infrastrukturore”, shkronja b “Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregëtare dhe parkimet për makinat”***
2. Ligji nr.10 448, datë 14. 7. 2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;
3. Ligji nr.10 431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar;
4. Ligji nr.10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”;
5. Ligji nr.10 279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
6. Ligji nr.10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
7. Ligji nr.9115 datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”.
8. Ligji nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në Mjedis”.
9. Ligji nr.8897 datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”.
10. Ligji nr.9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.
11. Ligji nr. 8094 datë. 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”.
12. Ligji nr.8766, datë 05.04.2001 “Për mbrojtjen ndaj zjarrit”
13. Ligji nr.9010 datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” i ndryshuar me Ligjin Nr.10 137, date 11.05.2009.
14. Ligji nr. 10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”.
15. V.K.M Nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”.
16. V.K.M Nr. 395, datë 21.6.2006 “Për miratimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për zhvillimin e turizmit, kulturor dhe mjedisor”.
17. V.K.M. nr.587, datë 07.07.201 “Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”.

18. VKM nr 249 “Për Dokumentacionin Ligjor dhe teknik të një VNM”.
19. V.K.M Nr.247, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore”.
20. Vendimi Nr. 99, datë 18.02.2005 i K.M. "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”.
21. Udhëzim, Nr.6, datë 27.11.2007 “Për miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afateve për përgatitjen e planeve të administrimit të mbetjeve të ngurta”.

## **2.5. Kuadri Ligjor Ndërkombëtar**

Shqipëria është një vend i cili tashmë është nënshkruar i shumë konventave dhe marrëveshjeve mjedisore dhe kjo ka ndihmuar në nxitjen e hartimit të ligjeve kombëtare mjedisore në përputhje me praktikën ndërkombëtare.

Ky raport duhet të përshtatet me ligjet dhe aktet ligjore në nivel lokal dhe ato kombëtare të cilat listohen më poshtë:

- Direktiva 2008/1/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 15 janarit 2008 "Mbi kontrollin dhe parandalimin e integruar të ndotjes", e ndryshuar, numri CELX: 32008L0001, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.24, date 29.1.2008, f. 8-29.
- Konventa për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në kontekstin ndërkufitar ESPOO, Finlandë, me 25 shkurt 1991.
- Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës (21 Maj 2008) “Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën”.
- Direktiva e Këshillit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.

## **3. ETAPAT E PROCESIT TË OPERIMIT**

### **1.2 Faza para ndërtimit**

Gjatë kësaj faze efektet mjedisore janë të përqëndruara kryesisht në hapësirën punuese dhe mund të jenë rezultat i punëve parapërgatitore. Këto aktivitete mund të shkaktojnë një ndotje lokale të ajrit dhe zonës së punës. Për këtë arsye janë propozuar edhe masat për parandalimin e këtyre ndotjeve, siç janë respektimi i procedurave të parapara sipas Ligjit për Ndërtimin dhe Ligjit për trajtimin e Mbeturinave që rezultojnë nga proceset e punës. Kryesisht këto efekte do të jenë si rezultat i prishjes së objektit ekzistues për krijimin e sheshit të punës për zhvillimin e projektit të kërkuar dhe hartuar nga specialistët përkatës për ndërtimin e hotelit.



## **2.5. Faza e ndërtimit**

Edhe gjatë kësaj faze disa efekte mjedisore janë kryesisht të përqendruara rreth hapësirës punuese. Faza e ndërtimit rezulton në zgjerimin e sipërfaqes së sheshit të punës pasi përmasat e objekti do të jenë pak më të mëdha se sa sipërfaqja ekzistuese, në përqëndrimin në hapësirën e sheshit të materialeve ndërtimore, në krijimin e mbeturinave nga materialet ndërtimore, ndotjen lokale e ajrit, shkarkimin e ujërave nga procesi i punës, si dhe aspektet e sigurisë në punë, etj. Për parandalimin e këtyre efekteve janë paraparë masat e nevojshme, siç janë respektimi i normave të ndërtimit të parapara me ligjin e ndërtimit, çështje e menaxhimit të mbeturinave dhe masat e tjera për zvogëlimin e ndotjes së ajrit dhe zhurmës. Dherat e gërmimit do të depozitohet në vend depozitimim e mbetjeve të ngurta sipas tipologjisë përkatëse të miratuar nga pushteti vendor.

## **2.6. Faza e operimit**

Faza e operimit është faza kur priten më pak efektet negative në mjedis. Kjo është e lidhur me shfrytëzimin e objektit për nevoja hotelerie. Gjatë shfrytëzimit të objektit nuk parashikohen efekte negative përpos faktit se do të ketë mjaft impakt pozitiv që ka të bëjë me ofrimin e shërbimit ndaj klientëve, sistemimin e hapësirës përreth, etj. Hoteli në funksionet e tij që ka të bëjë me prodhimin e ujrave sanitare, mbetjeve urbane, apo mbetjeve teknike apo teknologjike nga përdorimi i personave që shfrytëzojnë hotelin si dhe personeli i shërbimit do të jenë burim potencial i impaktit negativ mjedisor. Por me një sistem menaxhim të mirë planifikuar, me sigurimin e regjimit hidrik nga rrjeti furnizues si dhe të ndërtimit të sistemit të kanalizimit të ujrave të zeza, pjesë e sistemit të kanalizime ekzistuese të zonës, impakti negativ bëhet pothuajse i papërfillshëm.

## **2.7. Karakteristikat e projektit**

### **2.7.1. Madhesia e projektit**

*Objekti: “Hotel 6 katësh, (me funksion akomodimi, shërbimi, bodrum)*

*Sipërfaqja e pronës 167.5 m<sup>2</sup>*

*Sipërfaqja e ndërtimit 147 m<sup>2</sup>*

*Koefiçienti i shfrytëzimit të truallit 87.7 %*

*Intesiteti I ndërtimit 8.1*

*Planvendosja e zhvillimit të objektit “HOTEL” (Bashkangjitur raportit Paraprak te VNM)*

### **Ekzistenca dhe planet e përdorimit të tokës në zonën e zhvillimit të projektit**

Zona ku do të zhvillohet projekti i kërkuar nga subjekti ndodhet në lagjen “18 Shtatori” të Bashkisë Gjirokastër. Në këtë zonë janë të zhvilluara vetëm ndërtime banimi dhe

shërbimesh të ndryshme (tregëti, shëndetsor, farmaceutik, mekanik, etj). Ndërtimi i propozuar ndodhet në pjesën jug-perëndimore të lagjes “18 shtatori”, duke plotësuar dekorin ndërtues të saj. Plani i përdormit të tokës në këtë zonë kadastrale është ndërtimor (pasi në truallin e kërkuar është një objekt ndërtimi ekzistues një katësh). Hapësira përreth është pothuajse tërësisht e zënë nga ndërtimet me shumë pak hapësira të gjelbra, këto kryesisht të kultivuara.

### **Përputhja e projektit me planet vendore, rajonale të zhvillimit.**

Megjithëse aktualisht nuk ekziston një plan zhvillimi urban i miratuar për bashkinë, mendojmë se projekti i propozuar përputhet me planet e qeverisjes vendore si dhe me planin e përputhshmërisë për studime të pjeshme, ku në zonë e kërkuar janë realizuar disa leje ndërtimi si pjesë e zhvillimit urban të zonës.

## **3. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I MJEDISIT NË ZONËN NË STUDIM.**

### **3.1. QËLLIMI I PROJEKTIT**

Projekti i propozuar synon **së pari** në prishjen e një banese ekzistuese që është pronë private e zhvilluesit me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup>. **Së dyti** duke kryer gërmimit e dhurës sipas projektit të kërkuar nga grupi i punës do të ndërtohet një hotel me 6 katesh (me funksion akomodimi, shërbimi, bodrum). **Së treti** për mirë shfrytëzimin dhe krijimin e pamjes estetike projekti parashikon të gjithë elementët aredues, të dekorit dhe funksional për të qenë pjesë integrale e bashkësisë së ndërtimeve të zonës.


### **3.2. Pozicioni gjeografik.**

Sheshi i ndërtimit të hotelit është pronë private e subjektit, me sipërfaqe 167.5 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi të projektuar 147 m<sup>2</sup>. Kjo pasuri gjendet në zonën kadastrale 8541, pasuria Nr. 26/57, lagja “18 Shtatori” Bashkia Gjirokastrë.

#### **Kufizimet e objekti janë:**

- Veriu: rrugë banesë
- Lindja: rrugë
- Jugu: rrugë
- Perëndimi: banesë - rrugë

Koordinatat e vendodhjes sipas sistemit Gauss Krüge janë:



**KOORDINANAT E PRONËS**

X = 40° 04' 46.6"                      Y = 20° 08' 23.0"

X = 40° 04' 47.0"                      Y = 20° 08' 23.6"

X = 40° 04' 46.7"                      Y = 20° 08' 23.9"

X = 40° 04' 46.4"                      Y = 20° 08' 23.4"

**Aksi Godines ekzistuese**

X = 40° 04' 46.8"                      Y = 20° 08' 23.6"

**3.3. Mjedisi Fizik.**

**3.3.1. Kushtet klimaterike.**

Gjirokastra ka klimë kontinentale të ashpër me dimër të ftohtë me shira e borë dhe verë të nxehtë e të thatë. Temperaturat ndryshojnë sipas stinëve. Në periudhën e dimrit ajo varion nga +5<sup>0</sup>C në -8<sup>0</sup>C, kurse në periudhën e verës ajo ndryshon në kufijtë 20-35<sup>0</sup>C. Reshjet në qytetin e Gjirokastrës janë të bollshme, kjo më e theksuar për periudhën Nëntor – Mars, ku për vitin 2005 spikatin reshjet e datave 30 Nëntor – 1 Dhjetor kur ranë 301 mm shi. Sasia mesatare vjetore e reshjeve është rreth 1800-2000 mm shi. Llogariten që ditët me shi në vit të jenë rreth 135 ditë. Regjimi mesatar vjetor i temperaturave luhatet nga 7,8<sup>0</sup>C deri në 28,8<sup>0</sup>C. Prania e e erërave me lagështirë është karakteristike për zonën.

### **3.3.2. Pedologjia dhe Gjeologjia e zonës.**

Përfaqësohet nga depozitime të kuaternarit që janë më tepër depozitime të tipit gjenetik proluvial të përziera me depozitime të fundit të shpatit dhe mbi to tipi gjenetik i përfaqësuar nga deluvione.

Këto depozitime janë rezultat i copëtimit, shkatërrimit, gërryerjes e transportimit të formacioneve rënjësore ku 60-70% e zënë karbonatet, 15-20% flishe dhe 10-15% argjila e suargjila të kores së prishjes. Këto depozitime vendosen mbi flishin argjilo – alevrolito – ranor e kanë trashësi deri 20m. Janë të favorizuara nga relievi i thyer e i përçarë, nga ndërtimi i shpateve, nga shpatet e luginave, ndërprerja e perrenjve të ndryshëm, klima me rreshje etj.

Në pjesët më të ulëta të relievit në prerjet vertikale të këtyre depozitimeve parë nga hapja e themeleve të thella janë dalluar deri 2-2.5 m deluvione të kores së prishjes (argjila -suargjila) ngjyre kafe, pastaj më poshtë copa gëlqerorësh, strallesh e ranoresh të parrumbullakosura e të pa sortuara të përziera me argjila e suargjila ngjyrë kafe.

### **3.3.3. Klasifikimi gjeoteknik i shkëmbinjve dhe karakteristikat gjeologo – inxhinjrike të tyre.**

Nga pikëpamje gjeoteknike prerja litologjike e zonës së Gjirokastrës duke marrë parasysh gjenezën, përbërjen e shkëmbinjve dhe vetite e tyre fizike, ujore dhe mekanike mund të ndahen në këto grupe shkëmbinjsh: shkëmbinj të fortë, shkëmbinj mesatarisht të fortë dhe shkëmbinj të shkrifët me lidhje kohezionale.

Zona ku do të ndërtohet objekti i kërkuar nga zhvilluesi ka këto veçori:

Shkëmbinjë mesatarisht të fortë me këto tregues fiziko-kimikë:

Janë shkëmbinjë me ndërthurje argjilo – alevrolite – ranore me predominimin here të njerit komponent herë të tjetrit. Këta shkëmbinj karakterizohen nga një qëndrueshmeri jo shumë e lartë ujore, deformim relativisht i lartë, erodohen nga uji, me sjellje elastiko – plastike dhe qëndrueshmëri të vogël në shpate. Janë analizuar të tre komponentet me kampione argjilor, kampione alevrolitor dhe kampione ranore. Treguesit fiziko – mekanike mesatar të prerjes flishore janë në këta kufij:

- Pështja vëllimore  $2.2 - 2.5 \text{ gr/cm}^3$
- Poroziteti 20 – 25 %
- Rezistenca në shtypje (varet nga shkëmbi argjilit, alevrolit apo ranor)  
 $200 - 400 \text{ kg/cm}^2$
- Moduli i elasticitetit  $200 - 300 \text{ kg/cm}^2$
- Kohezioni  $30 - 40 \text{ kg/cm}^2$
- Këndi i fërkimit të brendshëm  $19 - 23^\circ$
- Ngarkesa e lejuar  $2 - 4.5 \text{ kg/cm}^2$

### **3.3.4. Hidrologjia.**

Zona e përzgjedhur meqënëse ndodhet në periferi të lagjes “18 shtatori” karakterizohet nga prania e ujrave relativisht të thella nëntokësore që gjatë periudhës së verës shkaktojnë djersitje ndërsa në dimër mund të ketë dhe dalje të vogla ujore.

### **3.4. Mjedi biologjik**

Zona është me reliev mjaft të thyer dhe e ekspozuar nga veri-perëndimi. Për shkak të pranisë përreth të ndërtimeve të shumta të tipologjive të ndryshme (pallate banime, objekte social-ekonomike, etj) mjedi biologjik nuk është shumë i pasur në llojshmëri dhe sasi. Flora e kësaj zonë në tërësi së bashku me mjedisin rrethues karakterizohet nga fauna tipike sipas habitateve ekzistuese. Kështu flora përbëhet nga: **Bar gjarpëri** (*Ceterach officinarum Lam. Et Dg*), **Bari mijëfletësh** (*Achillea millefolium L.*), **Hardhia** (*Vitis vinifera L.*), **Hithra diotike** (*Urtica dioica L.*), **Kulpra** (*Clematis vitalba L.*), **Manaferra egër** (*Rubus fruticosus*), **Thana** (*Cornus mas*) **Dëllinja** (*lat. Juniperus communis*), **kumbulla** (*Prunus domestica*), **shega** (*Punica granatum*), etj. Regjimi i bimësisë përcakton edhe regjimin e faunës ku ka kryesisht zvarranik, insekte, flutura, shpendë të llojeve të ndryshme, gjitarë të vegjël (minj), si dhe kafshë shtëpiake si mace, qen, etj. Objekti ndërtimor i kërkuar nga zhvilluesi do të realizohet në një sipërfaqe që ka aktualisht një banesë dhe ndërhyrja e njeriut është prezente. E rëndësishme është të theksojmë se procesi ndërtimor do të shoqërohet me prishjen e objektit ekzistues dhe ndërtimin e një banese të re pothuajse në të njëjtën sipërfaqe (pak më e madhe) dhe me kryerjen e gërmimeve për krijimin e hapësirës së bodrumit.

### **3.5. Zona të mbrojtura, habitate dhe zona të ndjeshme. Specie në rrezik dhe grupime të veçanta.**

Zona e përzgjedhur për ndërtimin e hotelit nuk përmban në afërsi mjedise me status mbrotje, habitate të ndjeshme, specie dhe grupime të ndjeshme. Gjirokastra si pjese e UNESCOs është ndarë në tre zona për nga rëndësia arkitektonike duke filluar nga pjesa historike me status special, zona kufi dhe zona tampon. Praktikisht prona e zhvilluesit përkon me nivelin e tretë të trajtimit urbanistik, por projekti ka marrë në konsideratë arkitekturën tërësore të zonës.

### **3.6. MJEDISI SOCIAL.**

#### **3.6.1. Popullsia dhe infrastruktura**

Objekti që propozohet të ndërtohet nga zhvilluesi gjendet në pjesën jugore të lagjes “18 shtatori”, pjesë intesifikuar në ndërtime vitet e fundit, madje dhe me infrastrukturë jo shume efikase. Kështu që ndërtimi i kësaj banese nuk krijon stres mjedisor, social për pjestarë të komunitetit të lagjes. Ndërtimi i hotelit nuk shoqërohet me kërkesa ekstreme për ndërhyrje në regjimin e infrastrukturës sikurse janë rrugët, rrjeti i kanalizimeve, rrjeti i ujësjellësit, rrjeti

## Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis – “Ndërtim Hoteli”

elektrik, etj. Pasi fakti që banesa është eksituese dhe është shfrytëzuar sistemi i rrjetit të kërkuar ekziston, veçse kërkon standartat sipas projektit të kërkuar nga zhvilluesi.

### **4. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR.**

#### **4.1. Procedura ndërtimore.**

Puna ndërtimore përfshin përgatitjen e projektit urbanistik dhe arkitektonik, marrjen e masave paraprake dhe ndërtimin e hotelit sipas projektit. Puna ndërtimore do të zhvillohet në dy faza:

**Faza e parë** ka të bëjë me prishjen e banesës ekzistuese në hapësirën e së cilës do të ndërtohet hoteli.

Kjo fazë punimesh do të shoqërohet me prishjen e objektit ekzistues, selektimin e materialeve me qëllim riciklimin e mundshëm, me largimin e inerteve të prishjes me mjete motorike për në vend depozitimin e inerteve, me sistemin e sheshit të ndërtimit.

**Faza e dytë** ka të bëjë me fillimin e punimeve për ndërtimin e hotelit sipas projektit . Fillimisht do të bëhen gërmime për hapjen e themeleve të hotelit. Më pas do të fillojë ndërtimi i objektit me të gjithë elementët e parashikuar në projektin e hartuar nga grupi i arkitektëve.



Objekti ekzistues ku do të ndërtohet hoteli

#### **4.2. EFEKTET E MUNDSHME TË PROJEKTIT NË MJEDIS**

Janë analizuar dhe shqyrtuar me kujdes të gjitha efektet në mjedisin jetësor, qofshin ato efekte pozitive apo negative.

#### **4.2.1. Efektet gjatë fazës së para-ndërtimit**

Aktivitetet që do të kryhen gjatë fazës së para-ndërtimit, paraqesin disa efekte negative në mjedis, të cilat me një përkujdesje të vogël do të mund të minimizoheshin maksimalisht. Gjatë kësaj faze fillestare efektet në mjedis do të mund rezultojnë kryesisht nga:

- Emetimet e zhurmës nga makineritë e përdorura në shembje, ngarkim të inerteve dhe transportin e tyre;
- Emetimet e pluhurit, si rezultatet i dezormimit, ngarkimit dhe transportit të materialeve inerte;
- Kontaminimi i tokës nga rrjedhjet aksidentale të vajrave nga makinat;
- Mundësi ndotje gjatë qarkullimit të mjeteve të transportit nga objekti nëpërmjet rrugëve të lagjes “18 Shtatori” për në vend depozitimin e inerteve



Fasada e objektit ekzstues dhe hotelit të ardhshëm

#### **4.2.2. Efektet gjatë fazës së ndërtimit**

Gjatë fazës së ndërtimit të objektit do të mund të krijohen efekte të përkohshme negative në mjedis, por me një menaxhim të mirë të këtyre efekteve, nuk do të kishim ndonjë impakt të ndjeshëm negativ mjedisor.

Në vijim janë të përmbledhura efektet (ndikimet) e mundshme të projektit në mjedis.

#### **4.2.3. Degradimi i tokës**

Ndërtimi i objektit nuk do të shoqërohet me ndryshime të ndjeshme të mjedisit fizik pasi në zonën e projektit është një objekt ekzistues i cili do të prishet dhe zëvendësohet me hotelin. Pra nga aktiviteti nuk kemi asnjë lloj tjetërsimi të tokës. Rrugët komunikuese për operacione në objekt do të shfrytëzohen ato ekzistuese që rrethojnë objektin në pjesën veri-perëndimore, jug-perëndimore dhe lindore.

Meqënëse mjetet motorike do të shfrytëzojnë rugën e asfaltuara nuk ekziston mundësia e kontaminimit të tokës nga rrjedhjet aksidentale, por ekziston mundësia në ujrat e grumbullimit. Po ashtu ndotja e tokës mund vij edhe si rezultat i depozitimit jo adekuat të inerteve të ndryshme që krijohen nga shkatërrimi i banesës ekzistuese dhe depozitimi i materialeve të ndërtimit.

#### **4.2.4. Zhurma**

Si rezultat i punimeve për prishje dhe ndërtim pritet të kemi edhe emisione të zhurmës. Zhurma kryesisht është si rezultat i punës së makinerive punuese (makina transporti, matrapikut, etj) dhe trafikut të tyre.

#### **Përdorimi i burimeve natyrore.**

Në zbatimin e këtij projekti nuk do të përdoren burime natyrore siç janë ujrat nëntokësore, por në varësi të stinës mund ti takojmë ato në gjermimin e themelit në pjesën e shtesës, prandaj rekomandohet që punimet të kryhen në stinën e thatë të vitit.

#### **4.2.5. Emetimet në ajër**

Po ashtu edhe ndotja e ajrit vjen si rezultat i emisioneve të pluhurit nga aktivitetet punuese dhe nga lirimi i gazrave të automjeteve nga djegia e karburanteve.

#### **4.2.6. Krijimi i mbeturinave**

Si rezultat i aktiviteteve punuese do të kemi gjenerim të mbeturinave të ngurta, sidomos inerteve në fazën e prishjes së objektit ekzistues dhe më pak gjatë fazës së ndërtimit. Kjo do të jetë e kushtëzuar nga regjimi i punës nuk do të lejohen depozitime të shumta të materialeve ndërtimore. Ndërsa gjatë prishjes së objektit materialet që do të riciklohen do të sistemohen përkohësisht për të mos krijuar impakt negativ mjedisor.

#### **Volumi i shkarkimit të ndotjeve dhe zhurmës në mjedis.**

Përsa i përket volumit të shkarkimit të ndotjeve në mjedis ato do të jenë nga lëvizja e një sasive dheu nga dezormimi, gjermimi dhe hapja e themeleve, i cili do të transportohet në vendin e caktuar nga Bashkia dhe do të ndikoj në komunitet vetëm në momentin e



## Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis – “Ndërtim Hoteli”

gërmimit. Përsa i përket zhurmave ato do të jenë në momentin e dezormimit, gërmimit, transportit dhe ndërtimit të objektit dhe janë zhurma të makinerive si eskavatore, kamion, betoniere dhe e njerzve që punojnë në objekt. Volumi i tyre do të jetë si më poshtë:

Sasia e shkarkimeve të zhurmave në mjedis

Pajisja	Vlerat
Kamion	81-87 Leq dB (A) në distancën 15
Eskavator i lëvizshëm	76-78 Leq dB (A) në distancën 15
Kompresor ajri	76-79 Leq dB (A) në distancën 15

Burimi : EPA(USA) Atmospheric Emission Inventory Guidebook, CORINAIR, 1996.

### Tabela e emetimit të gazeve dhe pluhrave

SHKARKIMET	NOX	CH <sub>2</sub>	VOC	CO	N <sub>2</sub> O	CO <sub>2</sub>	GRIMCAT
Total gr/km	10.9	0.06	2.08	8.71	0.03	800	19.16

Sipas saj shkarkimet ditore nga trafiku rrugor, duke marrë 50 km rrugë në ditë për një kamion do të jenë si më poshtë:

$$\text{NOx} = 50 \text{ km} \times 10.8 = 0.000454 \text{ t/d (545 gr/d) (10 rrugë} \times 5 \text{ km)}$$

$$\text{CH}_2 = 50 \text{ km} \times 0.06 = 0.000003 \text{ t/d (3gr/d)}$$

$$\text{VOC} = 50 \text{ km} \times 2.08 = 0.000104 \text{ t/d (104 gr/d)}$$

$$\text{CO} = 50 \text{ km} \times 8.71 = 0.0004355 \text{ t/d (435.5 gr/d)}$$

$$\text{N}_2\text{O} = 50 \text{ km} \times 0.03 = 0.0000015 \text{ t/d (1.5gr/d)}$$

$$\text{CO}_2 = 50 \text{ km} \times 800 = 0.04 \text{ t/d (40000gr/d)}$$

$$\text{Grimca} = 50 \text{ km} \times 19.16 = 0.000958 \text{ t/d (958 gr/d)}$$

Sipas vlerësime shkarkimet kanë vlera shumë të vogla pa patur ndonjë efekt negative mbi banorët dhe mjedisin përreth.

Tabela e vlerës së shkarkimeve në ajër nga makineritë

Kamion, Eskavator, Kompresor, Fadrome	816.8	1889	206	216
---------------------------------------	-------	------	-----	-----

Burimi : EPA(USA) Atmospheric Emission Inventory Guidebook, CORINAIR, 1996.

### Mundësia e aksidenteve me pasoja në mjedis.

Mundësia e aksidenteve me pasoja në mjedis egziston si :

- Rënia e materialeve të ngarkuara në kamion në rrugën shesh ndërtimi – shesh depozitimi dhe për pasojë do të fluturojnë në ajër në trajtën e pluhrave, të cilat janë të dëmshëm për njerëzit dhe shkaktojnë ndotje mjedisore në distancë.
- Shkarkimi i mbeturinave si vajra dhe bojra në sipërfaqen e sheshit të ndërtimit.
- Hedhja e mbeturinave të ndërtimit nga katet e larta në tokë ku do të ngrihen pluhra të dëmshme për njerëzit.

**Masat që do të merren :**

- Transporti i materialit të gërmuar me kamiona të mbuluar me mushama.
- Të mos hidhen mbeturinat nga katet e mësipërme në sheshin e ndërtimit.
- Bojrat duhet të hollohen para hedhjes dhe të hidhen në vende që largohen me anë të tubacioneve për në vend depozitimet e caktuara.

**4.2.7. Shkarkimi i ujërave**

Aktivitetet e ndërtimit (puna me çimento dhe ndërtuese) mund të ndikojnë në shkarkimin e ujërave në ambientet përreth. Por në kushtet kur ky proces do të realizohet me lëndë të parë të siguruar nga subjekte të licensuar në prodhimin e tyre mundësia e infiltrimit është inekzistente dhe praktikisht nuk do të ketë shkarkime ujrash me ngarkesë të cfarëdo lloji tipologjie.

**4.2.8. Shëndeti i punëtorëve dhe siguria**

Shëndeti i punëtorëve mund të rrezikohet si rezultat i mungesës së pajisjeve adekuate të punëtorëve si dhe nga aksidentet eventuale. Aksidentet mund të ndodhin për arsye të ndryshme gjatë punës me ekskavator, kamionë dhe mjete tjera.

Shembujt për rreziqe potenciale janë:

- operimi me pajisje pa masa sigurie.
- përdorimi i kamionit me kushte jo të mira teknike.
- Mos zbatimi i sinjalistikës funksionale të operimit në objekt.
- mungesa e vëmendjes dhe seriozitetit gjatë punës, etj.

**4.3. Masat gjatë fazës së para ndërtimit**

Para fillimit të organizimit të vend-ndërtimit, duhet të bëhet rrethimi dhe sinjalizimi i vend-ndërtimit sipas praktikave më të mira. Në këtë fazë të operimit pasi të merren të gjitha

## Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis – “Ndërtim Hoteli”

masat organizative të duhura paraprakisht duhet ndërprerë rrjeti i furnizimit me energji elektrike dhe ai hidrik si dhe të kontrollohet për prezencë të rrjetit të gazit dhe më pas do të filloj prishja e objektit ekzistues dhe selektimi i inerteve me qëllim ripërdorimi, ndërsa pjesa mbetëse do të dërgohen me makina të mbuluara për në destinacionin përkatës.

Vend-ndërtimi duhet dhe do të organizohet sipas skemave standarde të organizimit të vend-ndërtimeve, në funksion të:

- mjeteve të cilat do të përdoren gjatë punëve ndërtimore;
- dinamikës së punëve ndërtimore;
- sigurimit të personelit të punës, kryesisht mbrojtjes së shëndetit publik.

Për mbrotje të mjedisit do të operohet në orare pune me shkarkime minimale në ajër (me regjim lagështie ajrore më të lartë), në kohë që përkon me kohën aktive të punës, duke përdorur makineri në gjendje të mirë teknike si dhe duke mënjanuar ndotjen e ajrit, ndotjen e tokës, efektin zhurmë, efektin shumator të veprimeve në objekt dhe komunitet.



Sistemi rrugor ekzistues

#### ***4.4. Masat gjatë fazës së ndërtimit***

Është e rëndësishme që vendi i operimit të shqyrtohet në lidhje me kushtet e pasigurta. Bazuar në këto shqyrtime, duhet të përgatiten rregullat për pikat e ndryshme të operimit. Në rast të ndryshimit të kushteve, atëherë duhet që edhe llogaritjet dhe rregullat e përmendura të rishikohen. Para fillimit të operimit, dhe gjatë punës ndërtimore, operatorët dhe mbikëqyrësit e tyre duhet dhe do të kontrollojnë në formë rutinore zonën e

operimit në lidhje me kushtet e pasigurta. Kushte të tilla duhet dhe do të raportohen menjëherë si dhe do të korrigojnë. Në këtë kontest ndërtuesi duhet të ndërmarrë këto masa:

- Mbikëqyrja e punimeve të bëhet rregullisht për të garantuar se kushtet e pasigurta janë duke u korrigjuar dhe se janë duke u respektuar praktikatat e sigurta.
- Dheu i gërmuar, do të dërgohet direkt duke koordinuar proceset e punës në vend depozitimin e inerteve.
- Të jepen udhëzimet për operatorët e automjeteve të rënda.
- Sigurimi i komunikimit mes punëtorëve në pikat e qasjes së automjeteve të rënda.
- Sigurimi që pajisjet janë të mirëmbajtura dhe që pajisjet e sigurisë janë funksionale.
- Sigurimi i zonës së ndërtimit nga qasja e personave të pa autorizuar
- Vendosja e sinjalizimit dhe shenjave drejtuese të komunikacionit
- Pastrimin dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e mjeteve të punës.

## **5. PROJEKTI QË DO TË APLIKOHET.**

### **5.1. FILLIMI I PROJEKTIT.**

#### **Faza operacionale në sistemimin e sheshit të ndërtimit**

Kjo përkon me hapin e parë të proceseve në shfrytëzimin e sipërfaqës së kërkuar. Fillimisht për vijshmëri normale të punës do të bëhet rrethimi i pronës së kërkuar nga zhvilluesi dhe ndërprerja e rrjetit elektrik dhe hidraulik nga specialistët përkatës për të garantuar sigurinë teknike në punë. Më pas me anë të mjeteve të rënda do të realizohet prishja e objektit ekzistues. Prishja do të realizohet me përdorim përkatësisht të çekiçit hidraulik për soletën dhe të çekiçit-kovë për muret. Materialet e nxjerra do të selektohen me qëllim ripërdorimin duke i sistemuar në hapësirën e pronës, ndërsa inertet me anë të makinave ku do të ngarkohen nga eskavatori me kovë do të dërgohen për në vend depozitimin e tyre.

Pas largimit të inerteve do të bëhen gërmimet për hapjen e themeleve të hotelit sipas projektit. Dherat e gërmimit do të transportohen me mjete të mbuluara për në venddepozitimin e tyre të miratuar nga pushteti lokal. Kjo fazë e punimeve do të zgjas rreth 7-8 ditë/punë ( $400\text{m}^3 : 4\text{m}^3/\text{makinë} : 5 \text{ rrugë në ditë} = 20-25 \text{ ditë}$ ). Sasia e materialeve inerte që do të zhvendosen do të jetë rreth  $400-450\text{m}^3$ .

### **5.2. FAZA E NDËRTIMORE E OBJEKTIT.**

Kjo fazë e veprimtarisë ka të bëjë me ndërtimin e hotelit në sipërfaqe prej  $147\text{m}^2$ . Kohë zgjatja e ndërtimit të objektit së bashku me tërësinë e punimeve që do të kryhen në mjediset e brendshme (shtrimi i rrjetit elektrik, hidraulik, suvatime, vendosja e pllakave, lyerja me hidromat, vendosja e aksesoreve të ndryshëm, etj) do të jetë rreth 24-26 muaj. Por koha

## Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis – “Ndërtim Hoteli”

intensive e punimeve që kanë të bëjnë direkt me mjedisin rrethues, me zhvillime punimesh voluminoze dhe përdorim mjetesh me fuqi motorike të lartë do jetë 8-10 muaj. Midis fazave të operacioneve të parashikuar do të ketë pauza që lidhen me maturimin e proceseve teknologjike që do të aplikohen në ndërtim.

**Karakteristika ndërtimore të hotelit të kërkuar nga zhvilluesi sipas gjeologjisë së zonës të hartuara nga inxhinieri janë:**

- Objekti me strukturë skelet beton arme
- Për formacioni gjeologji flishor argjilor u mor  $\bar{u} = 1.4 \text{ kg/cm}^2$
- Themelet në katin e banimit do të jenë me sistemin e plintave dhe trarëve lidhës.
- Skemat statike dhe llogaritjet e betonit janë kryer me kompjuter me metodën e elementeve të fundit me programin FESPA 3.2 (2003). Në këtë program janë të vendosura normat e Eurokodit dhe Normat Greke në Sizmicitet.
- Në këto llogaritje janë zbatuar standartet e Eurokodit – 2.
- Strukturat janë të llogaritura me standartet Shqiptare në fuqi dhe standartet Greke: EAK – 2003 (antisizmike) dhe EKOS – 2000 (betoni)

Dinamikë me lëvizje masash (për skemën statike).

- Për soletat e ndërkateve janë mbingarkuar me  $p = 200 \text{ kG/m}^2$ , ballkonet me  $p = 500 \text{ kG/m}^2$ .
- Pesha e mureve që shkarkon në trarë është  $800 \text{ kG/ml}$  (mure tulle me vrima horizontale) dhe me veshje termoizoluese në mes.
- Për një lidhje të masave dhe një bashkëveprim më të mirë të mureve me skeletin e objektit, muret do të ndërtohen me dy breza b – arme, një në kuotën e dritareve 1.00 m dhe tjetri në kuotën e arkitrarit 2.25 m. Këto breza armohen me  $4\phi 8$  dhe stafa  $\phi 8 / 25 \text{ cm}$ , shufrat xhunohen me fitilat e lëna në kollonat e betonit

### **6. NDIKIMET NË MJEDIS.**

Procesi i vlerësimit të ndikimit në mjedis të objektit HOTEL kalon në këto faza: **faza e parë**, përgatitore: ka filluar që nga momenti i përgatitjes dhe kompletimit të dokumentacionit ligjor e teknik, vijon me verifikimin e këtij dokumentacioni deri në marrjen e lejeve përkatëse mjedisore, ndërtimore, etj. **Faza e dytë**, ka të bëjë me fillimin e punimeve, përkatësisht me prishjen e objektit ekzistues dhe organizmin e punës për ndërtimin e Hotelit. **Faza e tretë**, pas mbarimit të punimeve ndërtimore ka të bëjë me shfrytëzimin e objektit dhe hapësirës përreth nga zhvilluesi.

## Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis – “Ndërtim Hoteli”

Nga aktiviteti në natyrë përfitohen ndikime në mjedis që mund të jenë pozitive dhe negative, afatshkurtër dhe/ose afatgjatë, të minimizueshme dhe/ose të eliminueshme. Në përgjithësi nga aktiviteti në ndërtimin e objektit Hotel, impaktet përmbajnë më shumë element pozitiv se sa negativ. Theksojmë se ndikimet negative të konstatuara në lidhje me objektin kanë efekt afatshkurtër, pra përkojnë vetëm me kohën e prishjes dhe të ndërtimit të ri. Ndërsa ndikime afatgjatë janë më të pakta dhe mirëmenaxhimi i tyre i minimizon deri në eliminim të plotë.

Më poshtë kemi trajtuar në mënyrë të përmbledhur impaktet e aktivitetit për të krijuar një zonë tërësisht funksionale për zhvilluesin por dhe për komunitetin si dhe mjedisin biologjik.

### **6.1. Ndikime në tokë:**

**Nga ndërtimi i Hotelit të kërkuar rezulton se:**

- Nuk ekziston mundësia e erozionit dhe probleme të mundshme stabiliteti;
- Nuk ka impakte nëse përdoren teknologjia e propozuar nga grupi i specialistëve përkatës
- Nën kontroll do të jenë rasti i substancave ndotëse të prodhuara nga automjetet: grimcat solide, të cilat vijnë nga korrozioni, metalet, gomat, sipërfaqja e rrugës, etj, plumbi, kadmiumi dhe komponimet organike (graso, vajrat lubrifikantë hidrokarbure etj).

### **6.2. Ndikimi në larminë biologjike.**

Ky impakt është vlerësuar në dy drejtime: **së pari** nga sipërfaqja biologjike e tjerësuar dhe **së dyti** nga influenca e ndërtimit në regjimin e faunës dhe florës periferike. Konstatohet se sipërfaqja biologjike e tjetërsuar është ish objekt ekzistues dhe si e tillë nuk përmban element me rëndësi biologjike, përveç disa bimëve shkurore dhe barishtore të shpërndara në mënyrë sporadike përreth truallit. Numri dhe rëndësia e tyre është e papërfillshme. **Së dyti** mjedisi përreth do të ketë një impakt shumë të shkurtër dhe të vogël gjatë ndërtimit nga prezenca e mjeteve dhe punëtorëve, por me përfundimin e punimeve mjedisi do të plotësohet mjaft mirë nga shfrytëzimi prej zhvilluesit duke rritur ndjeshëm performancën mjedisore dhe impaktin pozitiv në biodiversitet (faunë dhe florë)

### **Rrethana të papërshtatshme**

- Mos respektimi i kushteve të evadimit të inerteve gjatë fazave operacionale mund të shkaktojë dëmtim të mjedisit natyral dhe pamje të papëlqyeshme.
- Hedhja e papërshtatshme e tepër të materialeve mund të dëmtoj mjedisin njerezor dhe natyral.

### **6.3. Krijimi i pluhurave.**

## Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis – “Ndërtim Hoteli”

Pluhurat do të jenë të pranishme kryesisht gjatë shkatërrimit të objektit ekzistues, gjatë hapjes së themeleve të godinës së re si dhe gjatë transportit të inerteve. Më pak emetime pluhuri do të ketë gjatë fazës së ndërtimit dhe këto kryesisht nga qarkullimi i mjeteve të transportit. Koha e punës është e kufizuar por dhe ritmi i tyre do të jetë i tillë, megjithatë kemi marrë në konsideratë procesit e emetimit të pluhurve në mjedis dhe më gjerë. Për këtë qëllim nëqoftëse shfrytëzohen ditët pa erë ose me erë të pakët, ditët me regjim të lartë lagështie ajrore përdormi i mjeteve transporti të mbuluara ky impakt gati eliminohet. Masa të pakta pluhuri të imët do të ketë dhe nga qarkullimi i mjeteve të punës dhe manovrimi i tyre, por natyra jo toksike dhe e pakët e tyre nuk do të përbëj shqetësim.

### **6.4. Krijimi i zhurmave gjatë punimit.**

Zhurmat do të jenë të pranishme nga prezenca e dy elementëve: **së pari** makineritë e punës dhe **së dyti** kryerja e punimeve. Niveli i tyre nuk paraqet asnjë rrezik për njerëzit në punë dhe komunitetin. Sasia e mjeteve, koha ditore e punës, numri i njerëzve nuk sjellin asnjë efekt negativ akustik. Këto zhurma janë shumë herë më të vogla se zhurmat që lejohen në proceset normale të punës. Megjithatë makinat duhet të jenë të pajisura me mblules mbrojtëse për komandimin e tyre, ndërsa ndikimi në jetën e njerëzve është i papërfillshëm.

#### ***Në tabelën e mëposhtme jepet ndikimi i zhurmave***

Nr.	Lloji i ndikimit të zhurmave	Identifikimi i zhurmave
1	Rritja e nivelit ekzistues të zhurmave	I papërfillshëm
2	Rritja e nivelit të zhurmave si rezultat i punës së makinave dhe aktivitetit	I papërfillshëm
3	Nivel të lartë të zhurmave për njerëzit	I papërfillshëm
4	Nivel shqetësues zhurmave për kafshët	I papërfillshëm
5	Pengim shtegëtimit të kafshëve	S’ka
6	Pengim i aktivitetit jetësor të kafshëve	S’ka

- Një nga komponentet e ndotjes së ajrit është ndotja akustike që vjen nga zhurmat e vazhdueshme ose me intervale kohore të caktuar.
  - Normat për zhurmat urbane shkojnë nga 55-65 dB për ditën deri në 45-55 për natën.
  - Normat për zhurmat industriale përcaktohen të mos kalojnë vlerat si vijojnë 80-85 dB
- Gjate ndërtimit të mbahen zhurmat nën nivelin normal.

### **6.5. Ndikime në sistemet hidrike.**

Zhvilluesi duke kontaktuar me ndërmarrjen e ujësjellësit të bashkisë do të siguroj rrjetin e tij hidrik të furnizimit me ujë të pijshëm rregullisht. Ndërsa në rrjetin e ujrave sipërfaqësore nga

kryerja e punimeve do të ketë vetëm efekte pozitive pasi do të bëhet e mundur disiplinimi më i mirë i tyre, kjo lidhur me krijimin e mekanizmave mbrojtës të inodimit të segmentit rrugor, apo pronave kufizuese sipas projekti të realizuar nga grupi i projektimit të banesës.

#### **6.6. Ndryshimi i relievit ekzistues.**

Praktikisht aktiviteti nuk ka të bëjë me ndryshim të qënësishëm të relievit eksitues. Vetëm sipërfaqja ndërtimore do të rinivelohet, dhe do të ketë një rimodelim të relievit por duke ruajtur fizionominë e zonës, ndërsa të gjitha punimet e tjera do të respektojnë relievin ekzistues.

#### **6.7. Ndikime në komunitet.**

Ndërtimi i Hotelit të kërkuar nga zhvilluesi nuk ka asnjë efekt negativ në komunitet, për shkak të pozicionit dhe raportit me objektet e tjera social-ekonomike. Impakti negativ që lidhet me qarkullimin e mjeteve të transportit është tepër afatshkurtër por duke përzgjedhur kohën e punës (duke shmangur shumatoren me komunitetin) bëhet pothuajse inekzistent.

#### **6.8. Ndikime në trashëgiminë kulturore**

Nga analiza e impaktit të këtij aktiviteti rezulton se në zonën ku do të ndërtohet:

- Nuk ka objekte të kulteve fetare
- Për ndërtimin e Hotelit nuk do të ketë nevoj për ndërtim rrugësh të reja por do të shfrytëzohen ekzistueset
- Në pronën e zhvilluesit por dhe në afërsi të saj nuk janë gjetur objekte arkeologjike ose kulturore dhe nuk ka të dhëna që mund të ekzistojnë.
- Siç është specifikuar edhe më lart, nuk janë identifikuar zona me vlera kulturore dhe historike.

#### **6.9. Ndikimet nga emesionet**

- Pluhuri nuk mund të eliminohet ndonëse shkakton impakt të ulët
- Prania ose mungesa e plumbit, zinkut dhe ndotësve të tjerë varen nga përdorimi korrekt i karburanteve pa plumb dhe nga mirëmbajtja e duhur e motorit. Firot aksidentale (vaj, benzinë dhe lëndë toksike nga serbatorët)

#### **6.10. Ndikimet në cilësinë e ajrit**

Aktiviteti nuk shoqërohet me ndryshime të ndjeshme të cilësisë së ajrit për shkak të kohës së punës, natyrës së saj, tipit të punimeve, natyra e mjeteve motorike, gjendjes funksionale të tyre. Megjithatë ekzistojnë element që duhet të merren në konsideratë gjatë gjithë operacioneve të mundshme.

Mundësi të përkeqësimit të ajrit janë si rezultat:



## Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis – “Ndërtim Hoteli”

- ndotësve të tillë si SO<sub>2</sub>, NO<sub>2</sub>, lënda e grimcuar në pezull (PM 10) ozone troposferik, monoksidi i karbonit, komponime organike volative dhe materiale të rënda.
- pluhurave që ngrihen gjatë punimeve dhe tymrave nga materialet e ndërtimit, inerteve, dherave, etj.
- përbërësve organike avullues nga shkarkimet e makinave

Impakti negativ që mund të shkaktojnë këto faktor në ajër minimizohet në rast se kushtet e përcaktuara në raport zbatohen me rigorozitet nga subjekti ndërtues. Megjithatë zona nuk favorizon përhapjen në distancë.

### **6.11. Ndikimi në shërbimet publike**

Aktiviteti ndërtimor nuk ka asnjë impak në shërbimet publike pasi nuk ndërhet në sistemin ekzistues të tyre.

### **6.12. VLERËSIMI PËRMbledhës I NDIKIMEVE NË MJEDIS**

- Ndikime të ndotësve në cilësinë e ujit nuk ka;
- Nuk ka përqëndrim të emetimeve kimike;
- Ndikime në hidrologjinë e zonës nuk ka;
- Tiparet gjeomorfologjike të terrenit nuk ndyshojnë;
- Nuk ka ndikim negativ në peisazhin e zonës përkundrazi do të ketë impakt mjaft pozitiv pas përfundimit të ndërtimit;
- Nuk ka impakt negativ në gjelbërimin e zonës përkundrazi zona do të ketë punime gjelbëruese duke shtuar akoma më shumë zonë e gjelbër.

## **7. VLERËSIMI ANALITIK I SHKARKIMEVE DHE MËNYRA E TRAJTIMIT TË TYRE**

### **7.1. Shkarkimi i gazeve**

Prania e gazeve do të jetë gjatë gjithë fazës së kryerjes së punimeve, pra në shkatërrimin e banesës ekzistuese dhe ndërtimin funksional të hotelit. Më pas do të qarkullojnë vetëm mjetet e motorizuara dhe shkarkimet janë pjesë e qarkullimit normal, pa ndonjë impakt me rëndësi vlerësimi. Vlerësimi i shkarkimit të gazeve ka rëndësi në fazën e kryerjes së punimeve pasi do të përdoren mjete me fuqi të lartë motorike, si eskavatori, makina transporti, betoniere, etj. njëkohësisht vlerësohet se intesiteti i punimeve në njësi kohe do të jetë relativisht i lartë. Ndërkohë që qarkullimi i mjeteve motorike do të jetë pjesë e ciklit të shfrytëzimit të rrjetit rrugor.

Shkarkimi nga mjetet qarkulluese llogaritur me mesatare ditore të përdorimit të makinerive.

Shkarkimi	NOx	CH <sub>2</sub>	V O C	C O	N <sub>2</sub> O	C O <sub>2</sub>	Grimcat
Total g/km	10.9	0.06	2.08	8.71	0.03	800	19.16

## Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis – “Ndërtim Hoteli”

Duke llogaritur numrin e mjeteve që do të përdoren për shkatërrim, gjermim, ngarkim, transport, sistemim, hedhje betoni, transport të materialeve ndërtimore, etj si dhe kohën e punës, itinerarin e qarkullimit të tyre dhe markën e makinerive, konstatojmë këtë nivel të mundshëm shkarkimesh.

$$\text{NO}_x = 50 \text{ km} \times 10.9 \text{ g/km} = 0.000545 \text{ t/d}$$

$$\text{CH}_2 = 50 \text{ km} \times 0.06 \text{ g/km} = 0.000003 \text{ t/d}$$

$$\text{VOC} = 50 \text{ km} \times 2.08 \text{ g/km} = 0.000104 \text{ t/d}$$

$$\text{CO} = 50 \text{ km} \times 8.71 \text{ g/km} = 0.000435 \text{ t/d}$$

$$\text{N}_2\text{O} = 50 \text{ km} \times 0.03 \text{ g/km} = 0.0000015 \text{ t/d}$$

$$\text{CO}_2 = 50 \text{ km} \times 800 \text{ g/km} = 0.04 \text{ t/d}$$

$$\text{Grimcat} = 50 \text{ km} \times 19.16 \text{ g/km} = 0.000958 \text{ t/d}$$

(sipas projektit distanca e zhvendosjes së inerteve do të jetë  $5\text{km} \times 2 = 10\text{km}$  rrugë maksimale)

Përveç makinerive të transportit në objekt do të përdoren dhe makineri stacionere për shembje, ngarkim, hedhje betoni, etj të cilat nuk sjellim veprim akumulues të shkarkimeve dhe nuk përhapen për shkak të mjedisit rrethues të pronës së zhvilluesit.

Në punime mobile	Në punime stacionere	Totali
$\text{NO}_x = 0.000545 \text{ t/d}$	$0.0001362 \text{ t/d}$	$0.0006812 \text{ t/d}$
$\text{CH}_2 = 0.000003 \text{ t/d}$	$0.00000075 \text{ t/d}$	$0.00000375 \text{ t/d}$
$\text{VOC} = 0.000104 \text{ t/d}$	$0.000026 \text{ t/d}$	$0.00013 \text{ t/d}$
$\text{CO} = 0.0087 \text{ t/d}$	$0.002175 \text{ t/d}$	$0.01087 \text{ t/d}$
$\text{N}_2\text{O} = 0.0000015 \text{ t/d}$	$0.000000375 \text{ t/d}$	$0.000001875 \text{ t/d}$
$\text{CO}_2 = 0.04 \text{ t/d}$	$0.01 \text{ t/d}$	$0.05 \text{ t/d}$
$\text{Grimcat} = 0.000958 \text{ t/d}$	$0.0002395 \text{ t/d}$	$0.001198 \text{ t/d}$

Këto vlera janë llogaritur për kohën e pikut të punës dhe në kushtet e kërkuara të zbatimit të projektit. Por shfrytëzimi i kushteve klimaterike sikurse gjendja e lagështisë, erërave, mjeteve mbrojtëse etj do të minimizonte më tej shkarkimet dhe impaktin mjedisor të tyre. Gjithsesi hapësira e mjedisit të punës, vendodhja, mungesa e aktiviteteve në afërsi, rezulton në mungesën e impakti të ndjeshëm të këtij aktiviteti në mjedis gjatë fazës operacionale të ndërtimit. Stresi në biodiversitet është i përkohshëm, por raporti i sipërfaqes së punës me sipërfaqen totale dhe me ritmin e punimeve nuk do të shkaktoj impakt negativ sinjifikativ.

### **8. PLANI I MONITORIMIT MJEDISOR (PMM)**

Objektivi final i PMM është përmirësimi i performancës mjedisore të projektit dhe të siguroj që objekti i propozuar nuk shkakton nivel të papranueshëm të efekteve mjedisore.

Veçanërisht PMM do të përmbush funksionet si në vijim:

## Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis – “Ndërtim Hoteli”

- Përbush kërkesat e legjislacionit të Shqipërisë dhe atij ndërkombëtar.
- Lehtëson implementimin e masave lehtësuese mjedisore të trajtura në vlerësimin e impaktit mjedisor.
- Përcakton mekanizmin e monitorimit mjedisor dhe identifikon parametrat e monitorimit me qëllim që të:
  - Siguroj se masat lehtësuese të trajtuara më sipër implementohet në tërësi.
  - Siguroj efektivitetin e masave lehtësuese në minimizimin e efekteve të projektit në vlerat mjedisore.
  - Identifikon kërkesat për trajnime mjedisore në nivele të ndryshme
  - Përcakton komunikimin dhe protokollin e raportimit për menaxhimin mjedisor

Ky proces monitorues ka të bëjë me:

- 1- Zbatimin e projektit gjatë fazës parapërgatitore dhe ndërtuese të objektit
- 2- Zbatimin e projektit sipas miratimit përkatës.
- 3- Marrjen e masave për mos depozitim të inerteve.
- 4- Respektimin e kërkesave mjedisore në ndërhyrjen ndaj tokës, mjedisit fqinj, qarkullimin e mjeteve të punës dhe shkarkimet mjedisore të tyre.
- 5- Mos krijimin e ngarkesave mjedisore të paparishikuara, për shkak të volumit dhe kohës së punimeve.
- 6- Me vlerësimin e impaktit negativ në komunitet gjatë punimeve.

Çdo ndërhyrje në mjedis sado e vogël qoftë si pjesë e së tërës kërkon vlerësimin e mjedisit si habitat i përbashkët i të gjithë qenieve të gjalla, ku bashkëjetesa sociale, shoqerore, ekonomike, kulturore, etj., përbën bazën për të sotmen dhe të ardhmen e njerëzimit.

### **9. MONITORIMI I MJEDISIT**

Gjatë zbatimit të projektit për ndërtimin e hotelit do të zbatohet një plan monitorimi i mjedisit. Ky plan është hartuar për të monitoruar parametrat ekologjik dhe biologjik të mjedisit përreth objektit me qëllim krijimin e një sinergjie funksionale midis natyrës dhe ndërhyrjes së faktorit antropogjen.

Monitoruesi si specialist i këtyre fushave do të kontrolloj vijshmërinë e procesit ndërtimor konform legjislacionit përkatës mjedisor.

Zhvilluesi do të jetë patner bashkëpunimi dhe komunikimi jo vetëm me specialistin e mjedisit por edhe me atë sanitar, ndërtimor, etj.

**Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis – “Ndërtim Hoteli”**

**PASQYRA PËRMBJEDHËSE E INDIKATOREVE MJEDISORE**

Nr.	Lloji i ndikimit të zhurmave	Gjatë ndërtimit Po/jo	Gjatë shfrytëzimit Po/ jo
1.	Rritja e nivelit ekzistues të zhurmave	Po	Jo
2.	Rritja e nivelit të zhurmave nga punimet	E papërfillshme	Jo
3.	Ndikimi i nivelit të zhurmave në faunë	I papërfillshëm	Jo
4.	Ndikimi i zhurmave në migrimet e ndryshme.	Jo	Jo
5.	Ndikimi i zhurmave në aktivitetin jetësor të kafshëve.	jo	jo

Nr.	Lloji i ndikimit në florë dhe faunë	Gjatë ndërtimit po/jo	Gjatë shfrytëzimit Po / jo
1.	Shkatërrim të habitateve natyrore	E papërfillshme	Jo
2.	Copëtim ose izolim të habitateve të egra.	Jo	Jo
3.	Interferencë në rrugët natyrore të migrimit.	Jo	Jo
4.	Mundësia për migrim të faunës natyror.	Jo	Jo
5.	Ndryshimi i rrugëkalimit të shpendëve	Jo	Jo
6.	Ndryshim në llojshmërinë e kafshëve dhe të bimëve		
7.	Ulje të sipërfaqes së kulturave bujqësore	Jo	Jo
8.	Humbjen e specieve vëndase ose diversitetit gjenetik?	Jo	Jo

Nr.	Lloji i ndikimit në trashëgiminë natyrore dhe peisazhin mjedisor.	Gjatë ndërtimit Po/jo	Gjatë shfrytëzimit Po /jo
1.	Prishje apo ndryshim të peisazhit eksitues.	Jo	Jo
2.	Ndryshim apo dëmtim të zonave me vlera trashëgimie natyrore.	Jo	Jo
3.	Dëmtimi i vlerave ekoturistike.	Jo	Jo

Nr.	Lloji i ndikimit në qarkullim dhe transport.	Gjatë ndërtimit Po/jo	Gjatë shfrytëzimit Po /jo
1.	Shtimi i lëvizjes së automjeteve	I papërfillshëm	Jo
2.	Ndikime të rëndësishme në sistemin ekzistues të qarkullimit.	Jo	Jo
3.	Ndryshime ose/dhe pengesa në qarkullimin njerëzor.	Jo	Jo

Nr.	Lloji i ndikimit në shëndetin e njerëzve	Gjatë ndërtimit Po/jo	Gjatë shfrytëzimit Po /jo
1.	Ndikimi në shëndet nga burimet ushqimore	Jo	Jo
2.	Ndikimi në shëndet nga puna në linjë dhe përreth		

**Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis – “Ndërtim Hoteli”**

3.	tyre. Krijimi i burimeve ndotëse njerëzore direkt ose indirekt.	Jo	Jo
		Jo	Jo
Nr.	Lloji i ndikimit në cilësinë e ajrit.	Gjatë ndërtimit Po/jo	Gjatë shfrytëzimit Po/ jo
1.	Prodhimi i lëndëve dekompozuese	Jo	Jo
2.	Shkarkime të ndryshme atmosferike.	Të papërfillshme	Jo
3.	Aroma të pakëndshme	Jo	Jo
Nr.	Lloji i ndikimit në regjimin e ujit.	Gjatë ndërtimit Po/jo	Gjatë shfrytëzimit Po/jo
1.	Shkarkime ndotëse në lumë	Jo	Jo
2.	Ndryshimi i rrjedhjes së ujit	Jo	Jo
3.	Ndryshime në rrugët e rrjedhjes së ujrave nga		
4.	përmbytjet	Jo	Jo
5.	Ndryshime në sasinë e ujrave sipërfaqësore	Jo	Jo
6.	Ndryshime në rrjedhjen e burimeve nëntokësore	Jo	Jo
	Ndryshime në sasinë e ujit të destinuar për publikun	Jo	Jo
7.	Nxjerrje ose transferim të ujit nga nëntoka ose		
8.	sipërfaqet ujore?	Jo	Jo
Nr.	Lloji i ndikimit në tokë	Gjatë ndërtimit Po/jo	Gjatë shfrytëzimit Po/jo
1.	Ndryshime të vendosjes gjeologjike të shtresave.	Jo	Jo
2.	Ndryshime topografike ose të relievit.	I papërfillshëm	Jo
	Shtim të erozionit të tokës nga uji, era në këtë vend		
3.	ose larg tij.	Jo	Jo
4.	Ndryshime të sipërfaqes së tokës	E papërfillshme	Jo

**GJIROKASTER, MARS 2016**

**PLANVENDOSIA E ZHVILLIMIT TE OBJEKTIT : 'HOTEL' NE LAGJEN . 18 SHTATORI .  
GJIRONJASHER**

NUMERI I PROJEKUT  
NUMERI I SHIFRIT  
ZVILLIMET: **BEKUPSHITOLA**

1:1000  
1:1000



SHUMI I ARES: **FILIP DAMI**  
NR. LIP. A: 0741

SH. 11.200  
0m 5m 10m

**HARTA E PERDORIMIT EKZISTUES TE TONES NE L. 18 SHITAFORI - GJIROKASTER ZK.  
8541 PASTARIA NR.26/57 INDENSI HARTES GJ-G7/GJ-H7**



SKALA 1:1000



PUNONI I AAKU MULE DAKMI  
NR. LIGJ. A - 0741



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK,  
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES  
QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT



NUMRI SERIAL:  
SN-218713-02-14

## ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI

Personit të tatueshëm:

Rexhep Shkurti – Person Fizik

Statusi:

Aktiv

Me adresë kryesore:

Gjirrokaster, Cepo, Ura e kardhiqit, godine 1-kateshe afer zyrave te Komunes

I jepet ky numër identifikimi (NUIS):

L42605602A

Afati i veprimtarisë:

Nga: deri

DATA E REGJISTRIMIT

05/02/2014

DATA E LËSHIMIT

05-02-2014

SPORTELLI I SHËRBIMIT:

QENDRA KOMBËTARE E REGJISTRIMIT



Kjo certifikatë mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji (Emri, Mbiemri) i nëpunësimit të sportelit të mesëm.  
Kjo certifikatë është rreptësisht e ndaluar të plastifikohet





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 136 Prot.

Tirane, me 19.05. 2004

Vendimi Nr.6, Nr.021 Regj.

*ÇERTIFIKATË*

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

***Z.Rexhep SHKURTI***

Certifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

  
Ethem RUKA





## LICENCË

LN-7440-02-2014

NUIS/NIPT: L42605602A

Subjekti: Rexhep Shkurti

Adresa: Gjirrokaster, GIROKASTER, Cepo, KARDHIQ, Ura e Kardhiqit, godine 1-  
kateshe afer zyrave te Komunes

Kodi: III.2.A (1+2)

Kod tjetër:

Data e lëshimit: 07/02/2014

Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtarisë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

Emërtimi përshkruar i veprimtarisë

Auditim mjedisor dhe vlerësim i ndikimit në mjedis

Kufizime specifike

*Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi*

Dejtrime specifike

*Licenca ushtrohet sipas dejtremeve në legjislacionin në fuqi*

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Nënshkrimi i sportelit:

*Dozhina Isoraya*

*[Signature]*

